



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6494 Prot.

Roskovec, më 25, 08 2026

V E N D I M

Nr. 45, datë 25 / 08 /2026

“ P Ë R M I R A T I M R I S H P Ë R N D A R J E F O N D E S H N D Ë R M J E T P R O G R A M E V E N Ë B U X H E T I N E

B A S H K I S Ë R O S K O V E C P Ë R V I T I N 2 0 2 6 ”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 , pika 1.2 gërma b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , të ligjit Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” neni 45 , të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , gërma a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, vendimit të Këshillit të Bashkisë , të VKB Nr. 71 datë 24.12.2025 “Për miratimin e dokumentit përfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026” si dhe shkresa Nr. 4235/1 datë 20.07.2026 për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Bashkisë,

- V E N D O S I :

- I. Të miratohet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve për objektet e investime dhe shpenzimeve për operative & mirëmbajtje në buxhetin e vitit 2026 si më poshtë vijon:

Shtohet:

N R	G R	TIT	K A P	A R T	EMËRTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Njësia Shpenzuese	Vlera e plotë e objektit /shpenzimit që shtohet	2026	2027	2028
1	00	09120	5	231	Arsimi Bazë parashkollor	Bashkëfinancimi Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Ali Sollaku+kopësht dhe i ambjenteve sportive Vidhisht	Bashkia Roskovec	13,006,123	142,320	12,863,803	0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA EKONOMIKE

nr. 6330/1 Prot.

18.08.2026

Lenda: Relacion per Projekt-Vendimin "Për miratim rishperndarje fondesh ndermjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026"

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

Të nderuar anëtar/anëtare te KB !

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore" neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë , te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 "Për miratimin e dokumentit perfundimtar perfundimtar të PBA 2026-2028 dhe buxhetit të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarrjes vartëse për vitin 2026" si dhe shkresa nr.4235/1 datë 20.07.2026.Për shpalljen fitues te projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit.

Ju relatojme:

Në këtë projekt-vendim kemi përcaktuar përdorim të fondeve të ngelura nga prokurimet e zhvilluara për objektet e investimeve të planifikuara për vitin buxhetor 2026, është krijuar fonde i lirë nga lidhja e kontratave investime tjera.

Mendojmë përdorimin e fondit si më sipër në një objekte të ri investimi ,një shtesë në zërin rikostruksion i i shkollës 9-vjeçare Ali Sollaku + kopësht dhe i ambjenteve sportive Vidhisht .

Sipas projekt-vendimit bashkëlidhur bazuar në shkresa nr.4235/1 datë 20.07.2026.Për shpalljen fitues te projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit . :

1. Për këtë arsyeje do të jemi të detyruar që të bëjmë dhe ndryshimet përkatëse në PBA 2027-2029 , për pjesën e të pritshmit të vitit 2026 meqë janë dhe transferime ndermjet programeve dhe që këto fonde ishin miratuar në buxhetin fillestar me financim për vitin 2026 , afati perfundimtar i të cilave është data 15 shtator 2026 , datë në te cilin dërgohet në Ministrinë e Financave dhe PBA e rishikuar.

Për sa më sipër, propozojmë miratimin e Projekt-Vendimit “Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e bashkisë Roskovec për vitin 2026”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

Konc: E.Toro

Miratoi: D.Hoxha



K R Y E T A R
Majlinda Bafi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDESKRYETARI

Maksim Goga

